

Pjerina Gaxha

Mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Zyrën e Komisionerit. Ka një karrierë të gjatë pranë Autoritetit, pasi më parë ka qenë pjesë e Drejtorisë së Hetimit Administrativ, si edhe Drejtorisë së Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Është diplomuar si juriste dhe master shkencor pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Ka master profesional në Administrim Publik, pranë Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës. Është e pajisur me licensë avokatie nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Eksperienca të mëparshme të punës kanë qenë si pjesë e sektorit juridik në institucione shtetërore. Gjithashtu, ka eksperiencë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, gjatë angazhimit të saj profesional pranë Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, si juriste dhe As/avokate në dy projekte të UNHCR dhe Terre des Hommes. Ka zhvilluar trajnime të ndryshme si trajnimi i vazhdueshëm 2-vjeçar "Kurrikula për Mbrojtjen e të Dhënave" i projektit të BE "Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave", Europeaid/129606/C/SER/AL, është certifikuar si trajnuese për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut nga ASPA, etj.